

# Hylli i Dritës

*Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.*

(II. ad Cor. III. 17).

1. Në kerkesë per një « modus vivendi »	Fq. 499
2. Të pertrimt e rregullimit shoqner	„ 506
3. Jeta e vepra e J. Enrik Pestallozhit	„ 511
4. Zana e Vizitorit. — <i>Lahuta e Malcis</i>	„ 516
5. Per Historin e Alfabetit Shqyp	„ 529
6. Qyteti i Barit dhe Panagjyri i Lindjes	„ 536
7. Polmonite	„ 541
8. Njoftime historike mbi Argjipeshkvijt e Shkupit	„ 546
9. Biblioteka e « Hyllit »	„ 553
10. Quo Vadis...? — Pj. II. — 12	„ 89

SHKODER

Shtypshkroja Françeskane

1934.

## Pajtimtarvet të ndershem!

Per t' u a bâ edhe mâ të letë perpjekjen me në pajtimtarvet e lezuesvet t' onë në Tiranë, u bâjm me diejtë se per çdo informatë si edhe per pagesa e pajtime, mund t' i siellen drejt per së drejti **perfaqsesit t' onë, Z. Simon Shiroka**  
— **Kafe „Europa“ Tiranë.**

---

L A J M

### A t y n e

t ë c i l l t e kan mârrë rregullisht revisten t' onë e nuk e p a g u e j n p a j t i m i n as s' mërren vesht me né per ket pûnë, nuk do t' u a dergojm numrin e Dhetorit, e po nuk na u pergjegjen as at herë, kemi me kënë të ngushtuem

**prap e prap t' u a kerkojm sá na kan me detyrë,** së mrâmi edhe në mndyrë si nuk kâ m' u pasë ande as atyne vetë.

ADMINISTRATA

## Në kerkësë per një „modus vivendi...“

T' a vret synin e të kputë shpirtin një paknaqsi shqet-suese, e cilla vehtet oroe ndër tana çetat e rrethet e jetës nierzore, me perjashtim të një pakicës minimale qi gzon.

Krizi këdejt, krizi andej; krizi në financë, krizi në punë, n' industri, në tregti, në shoqni, në politikë etj. etj., e madje ndiehet tue u folë edhe per krizin moral ndër kohë t'ona.

Fletoret, të perditshmet e të perkohshmet, ashtu kongreset e konferencat ndër tanë artikujt e shkruem e ligjeratat e mbajtuna, sikurse nierzt e mdhaj ndër *exposés* të vet, tanë dájñ si të prekun e të pershkuem prej një droje, të kapërthyem me një problem të pazgidhun; ele mâ kjo Europa e jonë ká ngelë: hiq e mos kput, sod xën një muer, neser vën një gúr, atij mos i a prish, ktij mundou me i a goditë; spilcë më spilcë e provë mbas prove, dér të dalë prej krizit, si të krisë mirë e pernjimend, e të kalojë kjo kohë kapercimi e të fillojë epoka e ré...

A ká se si, agimi i shekullit XX, kulmi i shkencës e i kulturës të lngojë kaq ndieshem materjalisht e moralisht? të kalojë kaq e vorfen e e errët kjo perjudhë, e cilla — per mos me thanë regres — të shenjojë një *prájse me randsí në jeten e Europës?*

E prá kurr mâ me kujdes nuk u studjue çashtja shoqno-re, por edhe kurr, çë se mahet në mend, nierzimi nuk pat iluzjone mâ të mdhá per fatbardhsí të jetës. Shekulli i jonë pri-ti të korrtet e të gzote frytin e mundit të bâm per kulturë e qytetnim ndër shekuj të kaluem, e qe, në *vend me lumnuet, bota marë vuen.*

Nuk ásht per t'u bindë pse vuejtm. Vuejtjet, kurdoherë

